

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit M. G. nga fshati P. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 414 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.1346/2015 të datës 21.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e prokurorit të shtetit Fatos Ajvazi dhe të akuzuarit, me datë 04.01.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M. G. nga i ati B. dhe e ëma A. e lindur B., i lindur më datë *data e lindjes...* në fshatin P. Komuna e Prizrenit ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor i ndërtimtarisë, i martuar, baba i shtatë fëmijëve, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfë ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 02.04.2015, në fshatin P. Komuna e Prizrenit në shtëpinë e tij familjare, me qëllim të ndërhyrjes së pa autorizuar në njehsorin elektrik me numër 62199402, për shkak të shkyçjes nga rrjeti elektrik, për shkak të mos përmbushjes së obligimit lidhur me pagesën e energjisë elektrike, e heq dhe e dëmton vulën zyrtare pllombën distributive e vendosur nga personat e autorizuar të KEDS – Distribucioni në Prizren të cilat shenja janë vendosur për sigurimin e njehsorit elektrik dhe mundëson ri kyçjen në furnizim me energji elektrike.

Këso dore ka kryer veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPK.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 414 të KPK të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprën të re penale.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 30 €, të gjitha këto në afat

prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.1346/2015 të datës 21.12.2015, kundër të akuzuarit M. G. nga fshati P. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 414 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga e prokurorit të shtetit, gjykata shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit, i njëjti u deklarua se ka kuptuar aktakuzën, nuk e kundërshton provat materiale dhe e ndjen veten fajtor për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike në datë 02.04.2015, në fshatin P. Komuna e Prizrenit në shtëpinë e tij familjare i akuzuari M. G. si shfrytëzues i energjisë elektrike në amvisërinë e tij me shifër të konsumatorit 38704, pas kontrollit të pikës matëse nga ana e zyrtarëve të autorizuar të dëmtuarës, është konstatuar se i njëjti ka dëmtuar pllombën distributive në njehsorin elektrik numër 62199402, ashtu që ka bërë ndërhyrje të paautorizuar në pajisjet matëse elektrike dhe ka dëmtuar pllombën distributive të cilën e kanë vendosur personat e autorizuar të KEDS – Distribucioni në Prizren, me qëllim të sigurimit të njehsorit elektrik. Nga kjo del se në veprimet e akuzuarit më afër të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi, formohen të gjitha elementet e veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPK.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga e akuzuarit për veprimet e përshkruar si në përshkrimin faktik të aktakuzës, me ç'rast edhe nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka prova të papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht, sepse mbështet në fakte që përmban aktakuza nga se i akuzuari prej fillimit të kësaj procedure ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale të cilat i ka paraqitur përfaqësuesi i aktakuzës, të cilat nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK. Prandaj në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 414 të KPK dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me kusht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysht të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin morri parasysht faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunimi me organet e drejtësisë, sjellja korrekte e akuzuarit gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi i tij për kryerjen e veprës penale, gjendja materiale dhe statusore – është i gjendjes së dobët ekonomike dhe mbajtës i vetëm i familjes, kjo

është hera e parë që bie ndesh me ligjin, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.4 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2162/2015 të datës 04.01.2017

Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.